



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 439/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxhaj kryesues, Valstimir Dimić dhe Ferit Osmani, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, për shkak të kërcënimit të komisionarit, në seancën e panelit të mbajtur me 14.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

REUZOHEN ankesat si te pabazuara te subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) Anr.439/2010 dhe Anr. 454/2010

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar dy ankesa më datë 12.12.2010, me nr. 439 dhe 454, nga subjekti politik AKR, me te cilat pretendohet se në fshatin Dubravë komuna e Kaçanikut është larguar nga Qendra e Votimit Servet Baku në cilësinë e komisionarit sepse është kërcënuar nga komisionari e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe nga komisionari i subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

Në raportin e policisë të datës 12.12.2010, potencohet se komisionari e subjektit politik AKR është larguar QV-ja në Dubravë, pasi që ka kërkuar zëvendësim ngase ka qenë i sëmur dhe pas nje ore është bërë zëvendësimi me një pjesëtarë të të njëjtës parti. Në raport e policisë si përfundim theksohet nuk bëhet fjalë për asnjë kanosje për rastin konkret.

Në deklaratën e dhënë në polici të datës 12.12.2010, Servet Baftiu thekson se “ me përgjegjësi të plot deklaron nuk ka pasur kërcenim prej askujt e në këtë rast as nga ndonjë pjesëtarë i subjektit politik.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës me Anr. 439 dhe Anr.454 të cilat kanë të bëjnë me të njëjtin rast, gjeti se;

- ankesat janë te pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se pretendimet nga parashtruesi i ankesave, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë janë të pabazuara nga shkaku se nuk janë ofruar dëshmi për të besuar se kanë ndodhur shkelja e tillë nga komisionarët e subjekteve politike PDK dhe AAK. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 439/2010 më datën 14.12.2010.

